
2024

Raport mbi efektshmërinë dhe transparencën e projekteve për energjinë e rinovueshme

Financuar nga



Zbatuar nga



TABELA E PËRMBAJTJES

- 01.** Hyrje
- 02.** Vështrim i përgjithshëm ligjor
 - Legjislacioni ndërkombëtar
 - Ligjet, programet dhe studimet kombëtare
 - Pengesat gjatë vënies në jetë të Direktivës së BE
- 03.** Vetëprodhuesit
- 04.** Përshkrimi i aplikimit/ Procedurat për projektet e energjisë së përtëritshme në Shqipëri
- 05.** Aftësitë dhe kapacitetet e autoriteteve
- 06.** Hendeqe dhe pengesa të identifikuara
- 07.** Përfundime
- 08.** Rekomandime
- 09.** Bibliografia

CEM	Forumi Ministror për Energjinë e Pastër
DSO	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EU	Bashkimi Evropian
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
GCF	Fondi i Gjelbër për Klimën
GEFF	Mekanizmi i Financimit për Ekonominë e Gjelbër
GHG	Gaze serrë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar
IRENA	Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë e Rinovueshme
IFC	Korporata Ndërkombëtare e Financës
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NEA	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
NREAP	Plani Kombëtar i Veprimit “Për burimet e energjisë së rinovueshme”
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në Shqipëri
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
RECs	Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme
REDII	Direktiva “Për energjinë e rinovueshme” II
RES	Burimet e Energjisë së Rinovueshme
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara “Për ndryshimet klimatike”
WB	Banka Botërore

1. HYRJE

Zhvillimi i projekteve të energjisë së rinovueshme është thelbësor për rritjen e qëndrueshme të Shqipërisë dhe tranzicionin e saj energjetik. Megjithëkëtë, efektshmëria dhe transparenca në proceset ligjore janë vendimtare për të tërhequr investime, për të forcuar besimin e grupeve të interesit dhe për të përmbushur objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë.

Ky raport ofron një analizë të plotë të kornizës ligjore që rregullon projektet e energjisë së rinovueshme në Shqipëri, rolin e vetëprodhuesve dhe hapat procedurale që nevojiten për vënien në jetë të projekteve. Po ashtu, shqyrton kapacitetet institucionale të autoriteteve përkatëse, dikton hendeqet dhe pengesat kryesore me të cilat përballen grupet e interesit dhe paraqet rekomandime për përmirësimin në tërësi të efektshmërisë dhe transparencës në projektet e energjisë së përtëritshme.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM LIGJOR

Korniza politike për energjitë e rinovueshme ka në shumë vende të botës, por jo në të gjitha dhe shpesh në shkallë të ndryshme. Nxitja e energjive të përtëritshme është një përbërës qendror i tranzicionit global energjetik, ku përfshihen zhvillimi dhe funksionimi i këtyre teknologjive, përcaktimi, përpilimi dhe marrja e lejeve operacionale, përdorimi i tokës dhe standardet mjedisore që duhen përmbushur. Për më tepër, kornizat ligjore mbulojnë financimin e projekteve për energji të rinovueshme, skemat mbështetëse, stimujt fiskalë, lidhjet me rrjetin si dhe çështje të tjera me rëndësi, ku përfshihen autoritetet që përgjigjen për lejet, licensat, lidhjet me rrjetin, si dhe zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve për këto projekteve.

Një vështrim më i afërt mbi nxitjen e energjisë së rinovueshme përmes Bashkësive Qytetare të Energjisë në BE tregon rëndësinë që ka kuadri ligjor. Bashkësitë Qytetare të Energjisë përcaktohen ligjërisht në BE si pjesë e përpjekjeve për të kaluar drejt një sistemi energjetik të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të decentralizuar. Në vitin 2019, Parlamenti Evropian miratoi paketën “Energji e pastër për të gjithë evropianët” që, për herë të parë, ngriti një kuadër të mirëfilltë ligjor për konceptin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme dhe rolin e tyre në tregun e energjisë për arritjen e objektivave të përcaktuara nga BE. Neni 15 i Direktivës “Për energjinë e rinovueshme” (BE, 2018) mbi “nxitjen e energjisë nga burimet e përtëritshme”, thekson rolin dhe ndikimin e zhvillimit të bashkësive energjetike, duke pranuar që nxitja e tregut të energjisë së rinovueshme kërkon marrjen parasysh të kontributeve të tyre pozitive në zhvillimin rajonal dhe vendor, kohezionin social dhe krijimin e vendeve të punës.

Fuqizimi i vetë-konsumatorëve të energjisë së rinovueshme që veprojnë në mënyrë të përbashkët krijon gjithashtu mundësi që Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme (REC) të ngrejë efikasitetin e energjisë në nivel familjar dhe të ndihmojnë në luftimin e varfërisë energjetike përmes uljes së konsumit dhe tarifave më të ulëta të furnizimit. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe e autoriteteve vendore në projektet e energjisë së përtëritshme përmes Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme ka sjellë vlerë të shtuar si në rritjen e pranueshmërisë lokale të energjisë së rinovueshme, ashtu dhe në sigurimin e kapitalit shtesë privat, që përkthehet në investime lokale, më shumë zgjedhje për konsumatorët dhe pjesëmarrje më të gjerë të qytetarëve në tranzicionin energjetik. Ky angazhim lokal merr më shumë rëndësi në kontekstin e rritjes së kapaciteteve të energjisë së rinovueshme. Masat që u lejojnë Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme që të konkurojnë në kushte të barabarta me prodhuesit dhe aktorët e tjerë të mëdhenj, synojnë më tej rritjen e pjesëmarrjes së vendasve në projektet e energjisë së rinovueshme dhe, për rrjedhojë, rritjen e pranueshmërisë së tyre.

Në kuadër të kësaj direktive (BE, 2018), shtetet anëtare duhet të garantojnë që autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore të përfshijnë dispozita për integrimin dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme – duke përfshirë vetë-konsumimin e energjisë së përtëritshme dhe komunitetet e energjisë së rinovueshme – si dhe përdorimin e nxehtësisë dhe ftohjes së mbetur që përftohet. Këto konsiderata duhet të integrohen në proceset e planifikimit, duke përfshirë planifikimin e hershëm hapësinor, skicimin, ndërtimin dhe rinovimin e infrastrukturës urbane, zonave industriale, tregtare dhe të banimit, si dhe në infrastrukturën energjetike, si rrjetet e energjisë elektrike, sistemet e ngrohjes dhe ftohjes qendrore. Gjithashtu, shtetet anëtare duhet të nxisin organet administrative vendore dhe rajonale që, kur është e përshtatshme, në planifikimin e infrastrukturës së qytetit, të përfshijnë ngrohjen dhe ftohjen nga burime të rinovueshme, të këshillohen me operatorët e rrjeteve për të pasqyruar ndikimin e programeve të efikasitetit energjetik dhe reagimit ndaj kërkesës, si dhe dispozitat specifike për vetë-konsumimin e energjisë së përtëritshme dhe komunitetet e energjisë së rinovueshme.

Që nga prezantimi i Direktivës “Për energjinë e rinovueshme” (BE, Direktiva “Për energjinë e rinovueshme” EU/2018/2001, 2018), pjesa totale e burimeve të energjisë së përtëritshme në konsumin e energjisë në BE është rritur nga 12.5% në vitin 2010, në 23% në vitin 2022 (Eurostat, 2023). Sipas Raportit Sintetik Përfundimtar “Për energjinë e rinovueshme në BE 2021” (Hørman et al., 2022), konkurrueshmëria e BE-së në tregjet globale të energjisë së rinovueshme mund të forcohet më tej. Duke njohur kontributin potencial të bashkësive energjetike në arritjen e një sistemi energjetik më të sigurt, të përballueshëm dhe më të pastër për Evropën, plani “Repower EU” (BE, 2022) propozoi si objektiv politik të përbashkët ‘krijimin e një komuniteti energjetik për çdo bashki me popullsi mbi 10,000 vetë deri në vitin 2025’. Duke pasur parasysh nevojën për të përshpejtuar tranzicionin e BE-së drejt energjisë së pastër, Direktiva “Për energjinë e rinovueshme” (BE, 2018) u rishikua në vitin 2023.

Direktiva e ndryshuar EU/2023/2413 (BE, 2023) hyri në fuqi më 20 nëntor 2023, parashikoi një afat prej 18 muajsh për të ndërfutur shumicën e dispozitave të saj në legjislacionin kombëtar dhe vendosi një objektiv të ri të detyrueshëm për energjinë e rinovueshme prej të paktën 42.5% për vitin 2030. Direktiva e rishikuar paraqet masa më të forta për të garantuar shfrytëzim maksimal të të gjitha mundësive për zhvillimin dhe përvetësimin e energjive të përtëritshme. Më e rëndësishmja, ajo trajton një hendek thelbësor lidhur me vendosjen e energjive të rinovueshme në terren, duke thjeshtuar dhe përsheptuar procedurat ligjore për projektet e energjisë së rinovueshme.

Legjislacioni ndërkombëtar

Legjislacioni ndërkombëtar mbi projektet e energjisë së rinovueshme përfshin disa korniza, traktate dhe marrëveshje të projektuara për të nxitur zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe investimet në energji të pastër. Ndër nismat kryesore ndërkombëtare përmenden Marrëveshja e Parisit (2015), Objektivat e Kombeve të Bashkuara “Për zhvillim të qëndrueshëm”, Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian, Fondi i Gjellbër për Klimën (GCF), nismat e Forumit Ministror për Energjinë e Pastër (CEM) dhe Politikën e Financimit të Klimës. Objektiv i përgjithshëm dhe i përbashkët i këtyre politikave është zhvillimi i projekteve të energjisë së përtëritshme, trajtimi i objektivave klimatike të vendeve, garancitë për qasje në energji të përballueshme, të besueshme dhe të qëndrueshme për të gjithë, si dhe përmirësimi i efektshmërisë në energji. Figura 1 jep një pasqyrë të kësaj përmbledhjeje.




Figura 1: Politikat energjitike dhe objektivat e tyre të përbashkëta
Burimi: Autorët

Për të treguar diçka shumë mbi legjislacionin ndërkombëtar të lartpërmendur, Marrëveshja e Parisit (2015) u kërkon vendeve pjesëmarrëse që të paraqesin planet e tyre për pakësimin e lëshimit të gazrave me efekt serrë. Për më tepër, ajo nxit programe ndërtimi kapacitetesh për të fuqizuar vendet e jugut global që të vënë në jetë dhe të administrojnë projekte për energjinë e rinovueshme.

Objektivat e Kombeve të Bashkuara “Për zhvillimin e qëndrueshëm” (2015), të miratuara si pjesë e Agjendës 2030 “Për zhvillim të qëndrueshëm”, përfshijnë objektivin 7, që vë si objektiv “energji të përbalueshme dhe të pastër”, duke fuqizuar bashkëpunimin ndërkombëtar për të lehtësuar qasjen në kërkim, teknologji dhe në investimet në energji të rinovueshme. Po ashtu, brenda këtij kuadri, qeveritë nxiten që të zbatojnë politika që mbështesin adoptimin e energjisë së përtëritshme, siç janë subvencionet, stimujt fiskalë dhe tarifat e garantuara për furnizim (feed-in tariffs).

Në vitin 2010, gjatë Konferencës së Palëve (COP 16) të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara “Për ndryshimet klimatike” (UNFCCC) në Cancún, Meksikë, u themelua zyrtarisht Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF) si një mekanizëm financiar global për të mbështetur vendet e jugut global në përbalimin e sfidave të ndryshimeve klimatike. Ai ofron grante dhe kredi koncesionale (me lehtësira) për të ulur pengesat financiare për investimet në energji të përtëritshme.

Tjetër mekanizëm me rëndësi është Forumi Ministror për Energjinë e Pastër (CEM), një forum global në nivel të lartë, i themeluar në vitin 2010, për të promovuar politika dhe programe për energjinë e pastër, për të përshpejtuar tranzicionin global drejt energjisë së pastër dhe për të ndarë praktikat më të mira. CEM mbështet energjinë e rinovueshme përmes programeve dhe nismave bashkëpunuese që fokusohen në vendosjen e teknologjive, novacionin dhe përkrahjen e politikave. Disa nga këto nisma janë Clean Energy Solutions Center, International Solar Alliance etj.

Për më tepër, shumë institucione financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) kanë politika të veçanta për të nxitur investimet në energji të rinovueshme, veçanërisht në vendet e jugut global.

Në nivel evropian, BE mund të shihet si prijës global në legjislacionin mbi energjinë e rinovueshme, me direktiva si Direktiva “Për energjinë e rinovueshme” (BE, 2018), që vendos objektiva të posaçme për përdorimin e energjisë së rinovueshme nga shtetet anëtare. Siç u lartpërmend, korniza evropiane ka një qasje të duhur ndaj komuniteteve energjetike, që përfshin krijimin e grupeve vendore qytetare, kompanive dhe autoriteteve vendore që punojnë së bashku për të prodhuar, shpërndarë dhe konsumuar energji të përtëritshme në nivel vendor.

Direktiva “Për energjinë e rinovueshme” (BE, 2018), së bashku me Direktivën “Për tregun e energjisë elektrike” (BE, 2019), ngritën kuadrin kryesor rregullator që u mundëson qytetarëve, autoriteteve vendore dhe sipërmarrjeve të vogla që të marrin pjesë kolektivisht në prodhimin, shpërndarjen dhe konsumimin e energjisë.

Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme përkufizohen në nenin 2 (16) të Direktivës “Për energjinë e rinovueshme” si një entitet ligjor që mbështetet në pjesëmarrje të hapur dhe vullnetare, ka autonomi dhe kontrollohet efektshëm nga anëtarët ose aksionarët e tij; këta mund të jenë individë, sipërmarrje të vogla dhe të mesme (SME) ose autoritete vendore (përfshirë komunat).

Në vend që të përqendrohen te fitimi, ata fokusohen në ofrimin e përfitimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale për komunitetin e tyre (BE, 2018). Neni 2 (11) i Direktivës “Për tregun e energjisë elektrike” (BE, 2019) e përkufizon Komunitetin Qytetar të Energjisë si një entitet ligjor që vepron mbi bazën e pjesëmarrjes vullnetare, të hapur, që kontrollohet në mënyrë efektive nga anëtarët ose aksionarët që janë persona fizikë, autoritete vendore ose sipërmarrje të vogla dhe të mesme (SME). Aspektet kryesore të të dyja direktivave përfshijnë të drejtat e komuniteteve dhe individëve për të prodhuar, ruajtur dhe shitur energji, akses të paanshëm në rrjet, mbrojtje për të siguruar përballueshmëri dhe përfshirje, si dhe fokus të veçantë te projektet e energjisë së përtëritshme në shkallë të vogël dhe në pjesëmarrjen e komunitetit.

Në vend që të përqendrohen te fitimi, ata fokusohen në ofrimin e përfitimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale për komunitetin e tyre (BE, 2018). Neni 2 (11) i Direktivës “Për tregun e energjisë elektrike” (BE, 2019) e përkufizon Komunitetin Qytetar të Energjisë si një entitet ligjor që vepron mbi bazën e pjesëmarrjes vullnetare, të hapur, që kontrollohet në mënyrë efektive nga anëtarët ose aksionarët që janë persona fizikë, autoritete vendore ose sipërmarrje të vogla dhe të mesme (SME). Aspektet kryesore të të dyja direktivave përfshijnë të drejtat e komuniteteve dhe individëve për të prodhuar, ruajtur dhe shitur energji, akses të paanshëm në rrjet, mbrojtje për të siguruar përballueshmëri dhe përfshirje, si dhe fokus të veçantë te projektet e energjisë së përtëritshme në shkallë të vogël dhe në pjesëmarrjen e komunitetit.

Në renditjen globale të stimujve për komunitetet e energjisë, më të përdorurit janë tarifat e garantuara për furnizim (feed-in tariffs – FiTs), matja neto/faturimi neto i energjisë, grante, subvencione si dhe kredite e zbritje fiskale. Sipas skemave për tarifat e garantuara për furnizim, komunitetet paguhen për energjinë e rinovueshme që prodhojnë dhe fusin në rrjet.

Për shembull, ligji gjerman “Për burimet e energjisë së rinovueshme” (RFGj, 2023) mbështet prodhimin lokal të energjisë përmes tarifave të garantuara për furnizim (FiTs). Ndërsa, matja neto e energjisë (net metering) përdoret për të menaxhuar energjinë e gjeneruar nga sistemet e energjisë së rinovueshme dhe energjinë e konsumuar nga rrjeti, duke marrë parasysh një bilanc të përgjithshëm. Prodhues-përdoruesit (prosumers) me sisteme energjetike të përtëritshme mund të eksportojnë energji të tepërt në rrjet dhe, si shpërblim, marrin kredite në faturën e energjisë për energjinë e futur në rrjet.

Kjo siguron që prodhues-përdoruesit të paguajnë vetëm diferencën neto midis energjisë elektrike të futur në rrjet dhe asaj të marrë nga rrjeti gjatë një periudhe të caktuar. Sistemi i faturimit neto (net billing) funksionon në mënyrë të ngjashme, por prodhues-përdoruesit marrin një tarifë për energjinë e eksportuar, që zakonisht është më e ulët se çmimi me pakicë i energjisë elektrike. Sipas kësaj skeme, energjia e eksportuar vlerësohet financiarisht shpesh në bazë të çmimeve me shumicë dhe zbritet nga kostoja e energjisë elektrike të blerë nga rrjeti.

Tjetër model është ai i granteve dhe subvencioneve, ku qeveritë ofrojnë financim për të ulur kostot e instalimit të sistemeve të energjisë së përtëritshme. Një shembull janë grantet e financuara nga BE në programin Horizon 2020. Sipas Aktit “Për uljen e inflacionit” në SHBA (Kongresi i ShBA, 2022), pjesëmarrësit përfitojnë ulje të taksave mbi pasurinë, taksave mbi shitjet ose taksave mbi të ardhurat në rast investimesh në projekte të energjisë së rinovueshme.

Ligjet kombëtare, programet dhe studimet për praktishmërinë dhe qasjen me komunitetet e energjisë

Korniza e tanishme ligjore për projektet e energjisë së rinovueshme në Shqipëri përbëhet nga legjislacioni i ndryshëm parësor dhe dytësor, me objektiva të qarta për të nxitur zhvillimin e energjisë së përtëritshme, për të rritur sigurinë energjetike, për të pakësuar lëshimin e gazeve serrë dhe për t’u përafëruar me standardet e Bashkimit Evropian.

Raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë (BE, 2023, fq.115) vë në dukje që mbështetja e tepërt e Shqipërisë tek hidroenergjetika për prodhimin e energjisë elektrike mbetet një sfidë. Janë ndërmarrë disa hapa drejt larmisë në energji, ku përfshihet miratimi i një ligji të ri për burimet e energjisë së rinovueshme (prill 2023).

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.24/2023 “Për nxitjen e burimeve të energjisë së rinovueshme” (2023). Ky ligj krijon kuadrin legjislativ për nxitjen e energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme dhe rregullat për integrimin e vetë-konsumatorëve të energjisë së përtëritshme dhe komuniteteve të energjisë në sektorin elektroenergjetik. Ligji përafrohet pjesërisht me RED II (BE, 2018), përcakton stimujt kryesorë dhe strukturat rregullatore që nxisin investimet private dhe publike në teknologjitë e energjisë së rinovueshme. Për këtë arsye, ai paraqet një sistem skemash mbështetëse, ku përfshihen tarifatat “feed-in” dhe pagesat me prime për projektet në shkallë të vogël. Siç u përmend më herët, ai gjithashtu paraqet konceptin e komuniteteve të energjisë, duke e përcaktuar si një person juridik me këto karakteristika (2023):

- a) mbështetet në pjesëmarrje të hapur, vullnetare, autonome dhe e kontrolluar në mënyrë të efektshme nga aksionarët ose anëtarët që ndodhen në afërsi të projekteve të energjisë së rinovueshme që zotërohen dhe zhvillohen nga ky subjekt juridik;
- b) aksionarët ose anëtarët janë persona fizikë, sipërmarrje të vogla e të mesme ose autoritete vendore ku përfshihen bashkitë;
- c) që ka si qëllim parësor ofrimin e përfitimeve mjedisore, ekonomike ose sociale për aksionarët ose anëtarët e saj, ose për zonat komunitare ku ajo operon, dhe jo realizimin e fitimeve financiare.

Vlen të theksohet gjithashtu futja e konceptit të vetë-konsumatorit të energjisë së rinovueshme, ku përfshihen shumë hollësi lidhur me mënyrën e funksionimit të tyre. Ligji garanton që prodhuesit e energjisë së rinovueshme të kenë qasje të garantuar në rrjet, me kusht që të respektojnë kërkesa të caktuara teknike. Komunitetet e energjisë kanë përparësi në mbështetje, duke përfituar nga masa të tilla si procedura të thjeshtuara të lidhjes me rrjetin dhe stimuj të mundshëm financiarë. Sipas nenit 21 të ligjit (2023), çdo komunitet i energjisë së rinovueshme duhet të mundësojë dhe të nxisë familjet me të ardhura të ulëta ose ato në gjendje të cënueshme që të bëhen anëtarë. Për më tepër, ligji lejon që dhe kompanitë private të jenë anëtare të komunitetit të energjisë, për sa kohë që pjesëmarrja e tyre nuk përfaqëson aktivitetin e tyre kryesor tregtar ose profesional.

Sa i përket konsumatorit fundor dhe atij familjar, ata kanë të drejtë të bëhen anëtarë të një komuniteti të energjisë së rinovueshme dhe të ruajnë statusin e konsumatorit fundor me të gjitha detyrimet dhe të drejtat përkatëse sipas ligjit dhe kuadrit rregullator. Së fundi, ligji garanton të drejtën për të mos iu nënshtruar kushteve ose procedurave të papërligjura apo diskriminuese që pengojnë pjesëmarrjen në një bashkësi të energjisë së rinovueshme.

Sipas ligjit shqiptar nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” (2015) dhe në përputhje me dispozitat e ligjit “Për nxitjen e burimeve të energjisë së rinovueshme” (2023), Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është përgjegjës për licensimin, rregullimin e tarifave, për garantimin e zbatimit të legjislacionit kombëtar dhe standardeve të BE-së për projektet energjetike. Sa u përket komuniteteve të energjisë, ERE përcaktohet si autoriteti përgjegjës që cakton tarifat e rrjetit që pasqyrojnë koston, sipas metodologjisë së miratuar nga vetë ERE, si dhe tarifa, taksa e ngarkesa të tjera përkatëse. ERE duhet të garantojë që përcaktimi i këtyre tarifave të kontribuojë në mënyrë të përshtatshme, të drejtë dhe të ekuilibruar në ndarjen e përgjithshme të kostove të sistemit.

Sipas ligjit 24/2023 (2023), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin e politikave, përgatitjen e rregulloreve dhe bashkërendimin me investitorët dhe agjencitë për të lehtësuar miratimin e projekteve.

Më konkretisht, neni 21(5) i ligjit parashikon që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është autoriteti përgjegjës për të hartuar udhëzimet në lidhje me krijimin dhe funksionimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme. Përmes udhëzimeve të ministrit, autoriteti përcakton si vijon:

- formën juridike të themelimit të një komuniteti të energjisë së rinovueshme;
- kushtet për të garantuar pjesëmarrje të hapur dhe vullnetare;
- menaxhimin efikas të nismave të komuniteteve të energjisë së rinovueshme, që përqendrohet në lehtësimin e aksesit financiar dhe informativ, ndërkohë që siguron mbështetje rregullatore dhe ndihmë në ndërtimin e kapaciteteve për autoritetet publike në themelimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme, si dhe në ndihmën për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë;
- çështje të tjera përkatëse.

Sipas nenit 9 të të njëjtit ligj, Ministria duhet të krijojë programe të përshtatshme për informacion, rritje të ndërgjegjësimit, udhëzime dhe trajnime për të edukuar qytetarët mbi ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë aktivë. Këto programe do të nxjerrin në pah përfitimet, anët praktike si dhe aspektet teknike dhe financiare të zhvillimit dhe përdorimit të energjisë së përtëritshme, duke përfshirë vetë-konsumimin dhe pjesëmarrjen në komunitetet e energjisë së rinovueshme.

Ligji 24/2023 (RSh, 2023) kërkon gjithashtu që qeveria të ofrojë politika dhe masa për zbatimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (RSh, 2024) për nxitjen e vetëprodhimit të energjisë së përtëritshme dhe të komuniteteve të energjisë së rinovueshme.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 e qeverisë shqiptare (RSh, 2018) ka objektiv rritjen e kapacitetit të energjisë së rinovueshme dhe uljen e lëshimit të gazeve serrë. Qeveria e Shqipërisë ka miratuar gjithashtu Planin Kombëtar të Veprimit I dhe II “Për burimet e energjisë së rinovueshme” (NREAP) (RSh, 2018). NREAP bazohet në detyrimet e Shqipërisë si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (BE, 2006) për të respektuar direktivat e BE-së për nxitjen e burimeve të energjisë së rinovueshme. Shqipëria është e detyruar që të rrisë pjesën e energjisë së përtëritshme në konsumimin total përfundimtar të energjisë që, deri në vitin 2030, duhet të arrijë në 54%. Në këtë dokument, qeveria shqiptare njeh rëndësinë e sigurisë energjetike, që lidhet me zhvillimin e politikave strategjike për prodhimin e energjisë, larminë në miksin energjetik dhe/ose kursimin e energjisë.

Shumica e projekteve të energjisë së rinovueshme (RES) në Shqipëri kanë siguruar financim dhe mbështetje teknike nga organizata ndërkombëtare, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Botërore dhe programet e BE-së. Grante dhe kredite të ndryshme orientohen drejt zgjerimit të energjisë së rinovueshme, përmirësimit të infrastrukturës energjetike dhe forcimit të kuadrit rregullator.

EBRD ka financuar projekte për efikasitetin energjetik në Shqipëri, veçanërisht përmes Skemës së Financimit të Ekonomisë së Gjellbër (GEFF, 2024).

Ky program ofron kredi për familjet dhe bizneset për investime në teknologji me performancë të lartë, si panele diellore, boiler me efikasitetin energjetik dhe izolim shtëpiak. Ai është pjesë e një nisme më të gjerë në Ballkanin Perëndimor, që synon pakësimin e lëshimit të karbonit dhe nxitjen e përdorimit të energjisë së përtëritshme. Vlen të theksohet që EBRD ka siguruar financim dhe për OSHEE[1], kompania shtetërore e shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri, për të përmirësuar efikasitetin dhe besueshmërinë e rrjetit të shpërndarjes. Objektivat në këtë rast përfshijnë përmirësimin e planifikimit afatgjatë të investimeve në rrjet për të mbështetur depërtimin e energjisë së rinovueshme dhe krijimin e një këshilli sektorial të aftësive në energji për të diktuar nevojat e tregut për aftësi dhe për të lehtësuar dialogun midis kompanive, qeverisë dhe ofruesve të arsimit.

Për të mbështetur familjet në Shqipëri, programi GEFF është zbatuar në partneritet me institucionet lokale financiare, siç është Union Bank, që ka marrë 6 milionë euro për të rihuazuar në projekte të efikasitetit energjetik në sektorin e banimit. Programi ofron gjithashtu stimuj në formë grantesh, të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë, për të mbështetur më tej investimet e gjelbra.

Bashkimi Evropian ka mbështetur disa nisma në Shqipëri që synojnë përkrahjen e energjisë së rinovueshme, vetëprodhimit dhe komuniteteve energjetike. Këto përpjekje janë pjesë e përafrimit të Shqipërisë me paketën e BE-së “Energji e pastër për të gjithë evropianët” dhe angazhimet në kuadër të Komunitetit të Energjisë. Disa nga programet dhe nismat përfshijnë:

- mbështetje për komunitetet energjetike: BE, përmes programeve si Nisma Evropiane për Klimën (EUKI) dhe partneriteteve me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ka punuar për të promovuar kornizat rregullatore për komunitetet energjetike të udhëhequra nga qytetarët në Shqipëri.
- ndihmesë financiare dhe teknike: Shqipëria ka marrë mbështetje financiare dhe ekspertizë teknike përmes nismave të mbështetura nga BE, duke përfshirë financim për instalimin e paneleve diellore dhe fushata ndërgjegjësimi publik mbi përfitimet e vetëkonsumit të energjisë së përtëritshme.

Më tej, disa programe në Shqipëri që mbështeten nga Evropa fokusohen në përkrahjen e efikasitetit të energjisë dhe komuniteteve energjetike, duke përfshirë:

- Programi Ndërkufitar Interreg IPA Greqi-Shqipëri (Interreg, 2021): Ky program përfshin projekte që përkrahin ndërtesa me efikasitetin të lartë energjetik, “gati zero energji” (nZEB), dhe nxit krijimin e komuniteteve energjetike në rajone ndërkufitare si Gjirokastra. Po ashtu, mbështet qasje të përbashkëta për funksionimin e bashkësive energjetike dhe zgjerimin e praktikave të qëndrueshme përtej kufijve.

- Projekti “Smart Energy Municipalities” (Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike, 2022): i financuar nga Ambasada Zvicerane, kjo nismë piloton sisteme administrimi të energjisë në disa bashki të përzgjedhura në Shqipëri. Ajo synon të institucionalizojë efikasitetin e energjisë në nivel lokal, duke mbështetur jetësimin e politikës kombëtare të energjisë së Shqipërisë dhe duke nxitur ndërgjegjësimin publik për efikasitetin energjetik.
- Fondi i Hapur Rajonal për Efikasitetin e Energjisë (ORF-EE) (GIZ, 2022): Ky program mbështetet nga GIZ (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar), me bashkëfinancim nga BE, i cili në Shqipëri mbështet asistencën teknike dhe përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve për masat e efikasitetit të energjisë.

Së fundi, vlen të përmenden dhe mekanizma të ndryshëm të ndihmës dhe financimit ndërkombëtar, si programi i kërkimit dhe inovacionit Horizon 2020 i BE-së, Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (IPA) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), që nxisin energjinë e rinovueshme dhe projektet e energjisë komunitare në Shqipëri.

Në qershor 2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë miratoi Udhëzimin për lidhjen në rrjet të vetëprodhuesve (Shqipëri, 2019). Sipas këtij dokumenti, kapaciteti i lejuar i instaluar për prodhuesit e vegjël të sistemeve diellore ose me erë arrin deri në 500 kWp për të plotësuar nevojat e tyre për energji. Energjia e tepërt mund të transferohet në rrjetin kombëtar përmes një sistemi matjeje neto (net metering). Për këtë qëllim, vetëprodhuesit janë të detyruar të përdorin një matës dykahësh për të llogaritur çdo muaj bilancet e energjisë.

Sipas dokumentit udhëzues të Ministrisë, kushdo që dëshiron të lidhet me rrjetin duhet të dorëzojë tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dokumentacionin e mëposhtëm:

- plotësimi i formularit të aplikimit “Për skemën e matjes neto” dhe lidhja e matësit dykahësh sipas modelit të miratuar të publikuar në faqen e internetit të OSHEE-së (OSHEE, 2025)
- deklarimi i konsumit mesatar vjetor sipas historikut të dy viteve të fundit ose, në rast mungese të historikut, një raport auditimi energjie i lëshuar nga një auditor i certifikuar, si dhe propozimi për fuqinë elektrike të instaluar. Kapaciteti i fuqisë së instaluar për prodhimin vjetor të energjisë elektrike nga vetëprodhuesi do të përcaktohet bazuar në modelet e konsumit të dy viteve të fundit ose, në rast mungese të historikut, kjo llogaritje do të kryhet nga auditori i certifikuar i energjisë në raportin e auditimit energjetik.
- propozimi për pikën e lidhjes së centralit diellor (PV) me rrjetin, i miratuar nga një person fizik ose juridik i licensuar për lidhjen e centralit fotovoltai, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes të miratuar nga ERE.

- propozimi për modelin e matjes dhe veçoritë e tij teknike. Aplikanti është i detyruar, sipas ligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (RSh, 2023), që të instalojë një matës inteligjent dykahësh me shpenzimet e tij, në përputhje me kërkesat e OShEE-së dhe me Kodin e Matjes.

Pas dorëzimit të aplikimit në OShEE, subjekti e njofton aplikuesin brenda 30 ditëve nëse aplikimi është miratuar apo jo. Nëse OShEE çmon që aplikimi nuk është në përputhje me kërkesat e udhëzimeve të Ministrisë, brenda 5 ditëve njofton aplikantin për dokumentet që mungojnë në aplikim, të cilat duhen plotësuar nga aplikuesi brenda 10 ditëve. Vlen të përmendet që çdokush mund të aplikojë përsëri për lidhjen me rrjetin.

Brenda 6 muajve nga data e miratimit të aplikimit, vetëprodhuesi duhet të instalojë centralin diellor (PV) dhe të njoftojë OShEE-në për kryerjen e instalimit; përndryshe, aplikimi duhet të dorëzohet përsëri.




Figura 2: Diagram rrjedhës i procesit ligjor për instalimin e një centrali diellor
Burim: autorët

Para se sistemi fotovoltaik të nisë operimin, vetëprodhuesi duhet të njoftojë OShEE-në me shkrim, duke paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kopje të miratimit të aplikimit dhe të procesverbalit për inspektimit e sistemit të matjes të instaluar
2. Kopje e dosjes së sistemit, e nënshkruar nga projektues të licencuar për centralet e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe profesionistë të licencuar për ndërtimin e centraleve të prodhimit të energjisë, së bashku me konfirmimin nga vetëprodhuesit për sistemin fotovoltaik.

- manuale dhe tabela teknike të produkteve të sistemit PV, si: panele, invertorë, kablllo etj.
- të dhëna për qasje online në platformën e monitorimit të sistemit.

Sipas këtij udhëzimi, OShEE mund të shkëpusë instalimin në rast se vërtetohet që vetëprodhuesit kanë projektuar një central që gjatë një periudhe vjetore tejkalon konsumimin e energjisë së vetëprodhuesit[1], ose kur provohet që centrali është instaluar dhe/ose funksionon ndryshe nga projekti i miratuar. Në të gjitha rastet, OShEE njofton vetëprodhuesin dhe ndërhyr me ndërprerje vetëm pasi vetëprodhuesi nuk ka trajtuar propozimet specifike të OShEE-së.

Ligji (2023) u mundëson prodhuesve që të shesin energjinë e tepërt përmes marrëveshjeve dypalëshe ose drejtpërdrejt te furnizuesit. Për shembull, prodhuesit më të mëdhenj me licensë tregtimi mund të shesin energji elektrike në tregun e lirë përmes marrëveshjeve dypalëshe (PPA) me konsumatorë si fabrika ose kompani të mëdha, ndërsa individët ose sipërmarrjet që prodhojnë energjinë e tyre (<500 kW) mund të përdorin matjen neto (net metering), duke injektuar energjinë e tepërt në rrjet në këmbim të krediteve për të kompensuar konsumet e ardhshme. Kjo përfaqëson një ndryshim nga rregulloret e mëparshme, ku energjia e tepërt duhej shitur tek ofruesi universal i shërbimit me çmime të rregulluara.

Qartësisht, pas miratimit të ligjit “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë”, është e domosdoshme që të gjithë aktorët/institucionet (Këshilli i Ministrave, Ministri përgjegjës për Energjinë, Autoriteti Kombëtar i Rregullimit të Energjisë, Agjencia e Efiçencës së Energjisë) të ndërmarrin veprime për hartimin e akteve nënligjore përkatëse, si metodologjia e zbatimit ose rishikimi i procedurave të lejeve për zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme.

Neni 29 i ligjit (2023) parashikon që Këshilli i Ministrave, ministri përgjegjës për energjinë dhe Autoriteti Rregullator i Energjisë ngarkohen me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij. Udhëzimi i Ministrit të Energjisë datë 20 qershor 2019, në fuqi, mbështetet në paragrafin 4 të nenit 15 të ligjit nr.7/2017 (2017).

Pengesa gjatë vënies në jetë në Shqipëri të Direktivës së BE “Për energjinë e rinovueshme”

Zbatimi në Shqipëri i Direktivës së BE “Për energjinë e rinovueshme” përballet me disa pengesa strukturore për shkak të kapaciteteve institucionale, vendimmarrjes së pjesshme dhe procedurave burokratike. Kjo pjesë, së pari, përshkruan përgjegjësitë për zbatimin e ligjeve përkatëse dhe, më pas, nxjerr në pah pengesat strukturore shoqëruese që ekzistojnë aktualisht.

Sic u përmend në paragrafin më sipër, neni 29 i ligjit 24/2023 parashikon që, brenda 12 muajve autoritetet përgjegjëse do të miratojnë të gjitha aktet nënligjore që lidhen me komunitetet energjetike dhe vetëprodhuesit, ku përfshihen:

- caktimi i institucionit që do të ketë detyrat kryesore si agjenci përgjegjëse për energjinë e rinovueshme (neni 5, paragrafi 2);
- miratimi i metodologjisë për pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme (neni 6, paragrafi 2);
- miratimi i masave mbështetëse, rregullave dhe procedurave për përfitimin nga këto masa, për të nxitur arritjen e objektivit kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, ministri përcakton rregullat e hollësishme për vënien në jetë të çështjes së masave mbështetëse për burimet e përtëritshme të energjisë (neni 10, paragrafi 1);
- përcaktimi i të drejtave dhe përgjegjësisë të vetëprodhuesve të energjisë nga burimet e rinovueshme.

Ministri i Energjisë është përgjigjës që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të miratojë aktet nënligjore për zbatimin e nenit 21/6, që i referohet Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe përvijon politika dhe masa për nxitjen e vetëprodhimit të energjisë nga burimet e përtëritshme dhe të komuniteteve të energjisë së rinovueshme.

Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ngarkohet me miratimin, ndër të tjera, të akteve nënligjore vijuese:

- me propozim nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, miraton masa për rrjetin dhe tregun, për të minimizuar ndërprerjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga burimet e rinovueshme, dhe metodologjinë për vlerësimin e vëllimit të kufizuar të energjisë elektrike. Metodologjia e ERE-s merr parasysh vëllimin e kufizuar të energjisë nga injektimi në rrjet, për të ruajtur kapacitetet e magazinimit të gjeneratorëve me prioritet (neni 17, paragrafi 5);
- përcakton çmimin e energjisë elektrike të gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme.

Ligji (2023) ka parashikuar që në politikën energjetike për lejimin e projekteve të energjisë së rinovueshme, të përfshihen shumë institucione ku përfshihen ministritë, agjencitë dhe bashkitë. Kjo passjell probleme bashkërendimi mes autoriteteve, që mund të vonojnë dhe të vështirësojnë miratimin e projekteve energjetike. Përgjigjet nga pyetësi i zhvilluar për këtë raport kanë treguar që procedurat e aplikimit për instalimin e centraleve fotovoltaike për prodhimin vetë të energjisë kryhen nga ekspertë të punësuar nga kompani private të instalimeve, që njohin mirë dokumentet që duhen dorëzuar.

Më tej, u theksua që procedurat burokratike ndonjëherë zgjasin dy muaj a më shumë (kryesisht për shkak të pretendimeve nga OShEE që sistemi IT nuk funksionon, problemeve teknike me skanimin, dokumenteve të pasakta etj). Kjo përbën shqetësimin kryesor për investitorët më të vegjël për shkak të proceseve burokratike të ngadalta dhe njohurive të gjera për lejet ose licensat, gjë që shkurajon investitorët e mundshëm.

Ndonëse ligji hyri në fuqi në prill 2023 dhe, brenda një viti, organet përgjegjëse duhej të hartonin aktet nënligjore, shumica e këtyre akteve nënligjore mungon, çka prodhon paqartësi në kuadrin rregullator. Përveç kohës së gjatë të procedurave, tjetër shqetësim që u ngrit nga të intervistuarit ishte mungesa e rregullave të qarta dhe e metodologjisë për energjinë e tepërt që gjenerohet nga centralet fotovoltaike. Deri më sot, energjia elektrike e tepërt që hyn në rrjet nuk kompensohet dhe transferohet te Furnizuesi Universal i Shërbimit pa kompensim. Aspekte të tjera që ndikojnë në zbatimin e direktivës së BE-së lidhen me mundësi të kufizuara për financim. Financimi i projekteve në Shqipëri duhet ti përshtatet sektorit të energjisë së rinovueshme dhe tu drejtohet jo vetëm operatorëve tradicionalë të rrjetit, që do të thotë se zhvillimi i burimeve të energjisë së rinovueshme duhet të marrë parasysh rolin në ndryshim që konsumatorët kanë në prodhimin, shitjen, magazinimin e energjisë etj.



3. VETËPRODHUESIT


Zhvillimi i prodhues-përdoruesve të energjisë në Shqipëri është një objektiv për tranzicionin drejt energjisë së qëndrueshme. Prodhues-përdoruesit mund të jenë individë ose subjekte që prodhojnë dhe konsumojnë energjinë e tyre. Ligji “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë” (2023) garanton kuadrin ligjor për prodhues-përdoruesit, duke u lejuar individëve dhe sipërmarrjeve që të prodhojnë energjinë e tyre elektrike nga burime të rinovueshme dhe të fusin energjinë e tepërt në rrjet. Neni 3 i ligjit përkufizon “vetëkonsumatorin e energjisë së rinovueshme” si një konsumator përfundimtar që gjeneron energji elektrike nga burime të rinovueshme për konsum të vetin dhe që mund ta magazinojë ose ta shesë energjinë e gjeneruar vetë. Megjithatë, për vetëkonsumatorët e energjisë së rinovueshme jashtë sektorit shtëpiak, të tilla aktivitete nuk përbëjnë veprimtari kryesore tregtare ose profesionale. Ky ligj paraqiti një koncept të ri, atë të “vetëkonsumatorëve të energjisë së rinovueshme që veprojnë së bashku”, që përshkruan një grup prej të paktën dy konsumatorësh që veprojnë së bashku si vetëkonsumatorë të energjisë së rinovueshme dhe që ndodhen në të njëjtën ndërtesë ose bllok pallatesh.

Ligji ka caktuar një nivel të lejuar të kapacitetit të instaluar. Vetëprodhuesit e energjisë nga burime të rinovueshme kanë një kapacitet maksimal të instaluar prej 500 kWp, kanë të drejtë të gjenerojnë, konsumojnë, magazinonë dhe të shesin energjinë e tepërt të prodhuar, si përmes marrëveshjeve dypalëshe me furnizuesit e energjisë elektrike dhe marrëveshjeve të tregtimit me palë të tjera, sipas parimeve të barazisë dhe proporcionalitetit. Mbështetur në propozimin e ministrisë, qeveria miraton të drejtat dhe përgjegjësitë e vetëprodhuesve të energjisë nga burimet e rinovueshme. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton, ndër të tjera:

1. Skemën e kompensimit për vetëprodhuesit e energjisë nga burime të rinovueshme, mbështetur në metodologjinë e faturimit neto;
2. procedurën për trajtimin e aplikimit nga vetëprodhuesit e energjisë nga burime të rinovueshme, duke përfshirë afatet përkatëse;
3. kërkesat teknologjike dhe teknike, që përfshijnë por nuk kufizohen, në përditësimet e nevojshme të çështjeve për të mundësuar jetësimin e skemës së kompensimit;
4. rregullat për shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar vetë;
5. periudhën vjetore që do të përdoret për matjen e gjenerimit të tyre.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mirëmban dhe operon një sistem që regjistron informacion mbi emrin, vendndodhjen, kapacitetin dhe datën e fillimit të impianteve të vetëprodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, duke përfshirë çdo informacion shtesë sipas parashikimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave. Skemat mbështetëse për vetëprodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme duhet të jenë proporcionale, të kontribuojnë në objektivat e Qeverisë së Shqipërisë për energjinë e rinovueshme dhe të mos rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të asnjë segmenti të zinxhirit të furnizimit me energji elektrike. Skema duhet të miratohet paraprakisht nga Komisioni i Ndihmave Shtetërore në përputhje me legjislacionin për ndihmat shtetërore. Vetëprodhuesit e energjisë nga burime të rinovueshme që ndodhen në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë blloqet e apartamenteve, kanë të drejtë të veprojnë së bashku si vetëkonsumatorë të energjisë së rinovueshme dhe u lejohet që të organizojnë ndarjen e energjisë së përtëritshme që gjenerohet në vendin ose vendet e tyre, pa cenuar tarifat e rrjetit dhe tarifat, taksat, kontributet dhe tatimet e tjera përkatëse që zbatohen për secilin vetëprodhues energjie.

Në përmbyllje, diskutimi i mësipërm tregon qartë se ligji ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet themelore të vetëprodhuesve. Pos kësaj, ligji përcakton institucionet publike përgjegjëse për zhvillimin e projekteve të energjisë së rinovueshme nga vetëprodhuesit. Sipas ligjit (2023), Ministria e Energjisë përgjigjet për hartimin e rregullave të duhura që nevojiten për operimin e projekteve të energjisë së përtëritshme nga vetëprodhuesit. Sa i përket çmimit, ai duhet të përcaktohet nga ERE sipas metodologjisë së miratuar nga qeveria. Kur u pyetën për kostot e procedurave ligjore për instalimin e një centrali fotovoltaik për vetëprodhim, përgjigjet nga intervistat nuk specifikuan një vlerë të saktë të shpenzimeve për hartimin e dokumenteve. Megjithatë, nga përgjigjet e tyre nënkuptohet që procesi është i gjatë, mungon transparenca në lidhje me kostot, dokumentacionin e kërkuar dhe procedurat, pasi nuk ekzistojnë akte nënligjore referuese. Për më tepër, komunikimi me aplikantët duket se mbështetet në kanale joformale, si postimet në Facebook, të cilat mund të mos ofrojnë besueshmëri ose qartësi të mjaftueshme. Kanalet e komunikimit jozyrtar nuk mund të jenë në asnjë rast mjeti i duhur për të shpërndarë vendime ligjore.



Kjo gjendje e parregulluar për prodhues-përdoruesit më të vegjël mund të mbështetet më tej me të dhëna. Sipas të dhënave të ofruara nga ERE[1], në vitin 2024, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) u ka dhënë statusin e vetëprodhuesit 2,416 klientëve me një kapacitet gjithsej rreth 216,823 kWp. Pesha specifike e kategorive të kontratave me panele fotovoltaike të instaluar në rrjetin e shpërndarjes, duke pasur parasysh statusin e vetëprodhuesve sipas kategorisë së klientit dhe fuqisë së instaluar, është 94% sektor privat, 2% institucione publike dhe 4% familje.

Tabela e mëposhtme tregon të dhëna të imtësishme mbi kapacitetin e instaluar sipas kategorisë së kontratës për centralet fotovoltaike:

Lloji	Numri	Fuqia e instaluar fotovoltaike [në kWp]	Madhësia mesatare e centralit FV [në kWp]
Publik	51	2,159	42.33
Njësi familjare	705	8,799	12.48
Sektori privat	1,645	203,873	123.93
Ent publik por jo me buxhet shtetëror	15	1,992	132.80
Gjithsej	2,416	216,823	89.74

Tabela 1: Kapaciteti i instaluar për kategori kontrate për fotovoltaike në vitin 2024.

Burimi: ERE

Tabela 1 tregon që tranzicioni energjetik – duke marrë parasysh instalimet PV në vitin 2024 – kryesisht realizohet nga projektet më të mëdha të sektorit privat, me më shumë se 1,645 centrale me një kapacitet mesatar prej 123.93 kWp për impiant, ndërsa familjet luajnë një rol periferik me vetëm 705 impiante dhe me kapacitet mesatar prej 12.48 kWp për impiant. Këtu shfaqet realisht potenciali i papërdorur për vetëprodhuesit në nivel shtëpiak.

4. PËRSHKRIMI I PROCEDURAVE TË APLIKIMEVE PËR PROJEKTET PËR ENERGJI NGA BURIME TË PËRTËRITSHME NË SHQIPËRI

Zhvillimi i projekteve të energjisë së rinovueshme në Shqipëri kërkon përmbushjen e procedurave rregullatore, licencuese dhe teknike sipas kuadrit ligjor kombëtar. Si hap i parë, nevojitet përzgjedhja e vendndodhjes dhe një studim realizueshmërie për të kryer vlerësime ekonomike, teknike dhe mjedisore, me qëllim konfirmimin e mundshmërisë së projektit. Këtu përfshihen matja e burimeve (p.sh., të dhënat e erës ose diellit) dhe vlerësime për lidhjen me rrjetin elektrik.

Ndërtimi i një impianti të energjisë së rinovueshme (RE) në Shqipëri kalon nëpër këto hapa dhe leje:

1. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS): Kryhet dhe miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
2. Lejet nga Institucionet Shtetërore: Autorizimi për ndërtim dhe operim jepet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).
3. Leja e Ndërtimit: Pas miratimit mjedisor, aplikohet për leje ndërtimi nga Këshilli i Rregullimit i Territorit.
4. Licenca e Prodhimit: Merrja e licensës së prodhimit nga ERE, rregullatori i energjisë në Shqipëri.
5. Marrëveshja për Lidhjen me Rrjetin: Sigurimi i një Marrëveshjeje për Lidhjen me Rrjetin dhe Përputhshmërinë Teknike për t'u lidhur me rrjetin elektrik.
6. Ndërtimi: Ndërtimi fillon pasi të jenë marrë të gjitha lejet, licensat dhe marrëveshjet e nevojshme.
7. Vënia në Punë dhe Testimet: Kryeni testimet për të siguruar funksionimin e sigurt dhe përputhshmërinë me standardet e rrjetit dhe ato mjedisor.
8. Përputhshmëria e Vazhdueshme: Paraqisni raporte të rregullta mjedisore dhe teknike gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit, sipas kërkesave ligjore.

Duhet përmendur që çdo projekt mund të ketë kërkesa specifike, në varësi të llojit të tij (diellor, i erës, ujqor), shkallës dhe vendndodhjes, duke kërkuar një bashkërendim të ngushtë me institucionet vendore dhe rregullatorët. Siç tregohet imtësisht më poshtë, për realizimin e një projekti të energjisë së përtëritshme kërkohen disa dokumentacione, leje dhe licenca institucionale:

1. Propozimi i projektit dhe studimi paraprak i mundshmërisë

- Vlerësim i hollësishëm i realizueshmërisë së projektit.
- Vlerësime teknike, mjedisore dhe financiare.

2. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS):

- Raport i plotë mbi ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale.
- Regjistrimet e konsultimeve publike (nëse është e aplikueshme). Miratimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit i raportit VNMS.

3. Marrëveshja e koncesionit (nëse është e aplikueshme):

- Për projektet që përdorin burime ose tokë publike (p.sh., hidroenergji), një marrëveshje koncesioni nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).
- Dokumentet për tendera konkurses (nëse kërkohet).

4. Leja e ndërtimit:

- Aplikimi për leje ndërtimi dorëzohet në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT) të Shqipërisë
- Planet e vendndodhjes, dokumentet e projektimit dhe masat për zbutjen e ndikimeve mjedisore.

5. Marrëveshja për Lidhjen me Rrjetin:

- Marrëveshje me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë (OShEE) ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) për lidhjen me rrjetin.
- Rishikim teknik, vlerësimi i kapacitetit të rrjetit dhe dokumentacioni i projektimit për lidhjen.

6. Aplikimi për Licensën e Prodhimit:

- Informacion teknik, ekonomik dhe financiar për ERE-n.
- Vlerësimet e ndikimit të projektit mbi rrjetin elektrik.
- Leje nga agjenci të tjera (p.sh., AKM, MIE, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe impianteve hidroenergjetike).

7. Leja e Operimit:

- Raportet përfundimtare të përfundimit të projektit.
- Dokumentacion për inspektimin dhe përputhshmërinë.
- Certifikimi i standardeve për sigurinë dhe mjedisin.

Sa u përket vetëprodhuesve, lidhja me rrjetin ndjek udhëzimet e Ministrisë, siç është përshkruar më parë në këtë raport. Një krahasim i kërkesave dhe karakteristikave për projektet e mëdha të energjisë së rinovueshme përkundrejt vetëprodhuesve shfaq dallime të rëndësishme, që paraqiten në tabelën e vijuese:

Kërkesa dhe karakteristika	Projekte të mëdha të energjisë së përtëritshme	Vetëprodhues në nivel të ulët (prodhues-përdorues që prodhojnë energji të përtëritshme për vetëkonsum (< 500kW))
Autorizim nga Ministria e Energjisë	Autorizim nga Ministria e Energjisë ose nga Këshilli i Ministrave	I përjashtuar
Licensë nga ERE	Kërkohet licensë prodhimi nga Autoriteti Kombëtar i Rregullimit të Energjisë	I përjashtuar
Vlerësim mjedisor	Kërkohet Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), duke përfshirë studime mbi përdorimin e tokës, biodiversitetin, ndikimin social dhe masat për zbutje.	Zakonisht përjashtohet për shkak të ndikimit minimal mjedisor.
Leje ndërtimi	Pas miratimit mjedisor, nevojitet leje ndërtimi, që miratohet nga Këshilli i Territorit.	Procedura të thjeshtuara; mund të mos jenë gjithmonë të nevojshme
Lidhja me rrjetin	Kërkohet marrëveshje me OShEE-në ose me OST-në	Procedura të thjeshtuara për lidhjen; Kërkohet instalimi me shpenzimet e veta i një matësi dykahësh, bazuar në udhëzimet e ministrisë
Kostot e investimit	Kosto më të larta përgjithësisht për shkak të tarifave të lejeve, marrëveshjes për përdorimin e tokës dhe investimeve në infrastrukturë	Investim fillestar më i ulët krahasuar me projektet në shkallë të gjerë

Stimuj	I përshtatshëm për Kontrata për Diferencë (CfD) ose kontrata premium përmes tenderëve konkurrues	Përfiton nga skemat e faturimit neto për të kompensuar konsumin dhe për të marrë kompensim për energjinë e tepërt
Raportimi	Gjatë ndërtimit dhe operimit kërkohet që të dorëzohen raporte të rregullta mjedisore dhe teknike.	Kërkesa minimale për raportim, kryesisht për llogaritjen e energjisë dhe përputhshmërinë me rrjetin.
Modifikimi i projektit	Flexibilitet i kufizuar pas vënies në funksion; zgjerimi kërkon leje dhe miratime të reja.	Flexibilitet më i madh – vetë-prodhuesit mund të rrisin kapacitetin brenda kufijve ligjorë.

Tabela 2: Krahësimi i kërkesave dhe karakteristikave midis Projekteve të Energjisë së Rinovueshme me Shkallë të Madhe dhe Projekteve të Vogla të Energjisë së Rinovueshme (<500kW).
Burimi: Autorët

Në Shqipëri, projektet e vogla të energjisë së rinovueshme (RE) – veçanërisht ato me kapacitet më pak se 500 kW – përfitojnë ca përjashtime nga disa prej kërkesave më komplekse dhe të kushtueshme që zbatohen për projektet e mëdha të RE. Ndonëse projektet e vogla RE nuk janë plotësisht të përjashtuara nga marrëveshjet për lidhjen me rrjetin, procesi është zakonisht më i thjeshtë krahasuar me projektet në shkallë të gjerë, duke mundësuar vënien në jetë pa investime të mëdha infrastrukturore dhe funksionim me një barrë rregullatore më të ulët.



5. AFTËSITË DHE KAPACITETET E AUTORITETEVE

Krijimi i komuniteteve të energjisë kërkon aftësi dhe kapacitete të posaçme nga autoritetet vendore, institucionet e specializuara dhe organet shtetërore. Nevojitet të kuptuarit dhe rëndësia e komuniteteve të energjisë, si dhe vullneti politik për të mbështetur aktorë si bashkësitë e energjisë. Për të nxitur projektet e energjisë së përtëritshme, ku përfshihen komunitetet e energjisë dhe vetëprodhuesit, është thelbësore ekspertiza ligjore dhe rregullatore, njohja me Direktivën e BE-së për Energjinë e Rinovueshme (BE, 2023) dhe paketën “Energji e pastër për të gjithë evropianët”, korniza që nxisin komunitetet e energjisë dhe modelet e prodhues-përdoruesve.

Autoriteteve u mvishet përgjegjësia për të hartuar aktet nënligjore, thelbësore për përkrahjen e projekteve të energjisë së përtëritshme. Pyetësi i përdorur për këtë raport tregon që intervistat nxjerrin në pah mungesë informacioni mbi procedurat dhe afatet kohore. Në këtë këndvështrim, autoritetet duhet të jenë të afta në hartimin e politikave dhe rregulloreve që mundësojnë komunitetet e energjisë, siç janë thjeshtimi i proceseve, sigurimi i qasjes transparente në rrjet dhe vendosja e tarifave të favorshme për projektet e energjisë komunitare.

Përveç njohjes së kuadrit të duhur ligjor në BE, autoritetet duhet gjithashtu të pajisen me kapacitete teknike për energjinë e rinovueshme dhe administrimin e rrjetit. Autoritetet duhet të kenë ekspertizë në teknologji të ndryshme të energjisë së rinovueshme, sidomos në panelet diellore (PV) dhe sistemet e erës në shkallë të vogël, që janë të përshtatshme për modele komunitare. Këtu përfshihen të kuptuarit e instalimit, mirëmbajtjes, performancës dhe monitorimit. Për të mbështetur bashkësitë e energjisë, autoritetet vendore kanë nevojë për njohuri në administrimin e rrjetit, duke përfshirë integrimin e burimeve të shpërndara të energjisë (DER), si parqet diellore ose me erë.

Përpos kësaj, autoritetet duhet të jenë të afta që të sigurojnë financim nga burime ndërkombëtare, si grantet e BE-së, bankat zhvillimore apo obligacionet (bondet) e gjelbra për projektet e energjisë në bashkësi. Të kuptuarit se si strukturohen opsionet e financimit është thelbësor që projektet e energjisë të bëhen të qasshme dhe të përballueshme për pjesëmarrësit.

Duke marrë parasysh zotërimin asimetrik të informacionit, autoritetet duhet të jenë të afta të zhvillojnë fushata të efektshme sensibilizimi për të edukuar publikun mbi përfitimet nga bashkësitë e energjisë. Këtu përfshihen njohuri mbi energjinë e rinovueshme, efikasitetin energjetik dhe përfitimet ekonomike nga prodhimi lokal i energjisë. Për më tepër, autoritetet duhet të nxisin bashkëpunimin midis qytetarëve, bizneseve vendore dhe institucioneve shtetërore për të ndërtuar besim dhe për të nxitur investime vendore në projektet energjetike. Një shembull i qartë i rolit të informacionit shihet në përgjigjet e intervistuarve. Kur u pyetën, ata deklaruan se nuk ka akte nënligjore apo udhëzime për tu referuar. Gjatë angazhimit me qytetarët, u tregua vetëm një postim në Facebook, që i referohet faturimit vjetor të energjisë elektrike.

Autoritetet duhet të jenë të afta që të mbledhin dhe të analizojnë të dhënat mbi përdorimin e energjisë për të projektuar efektshëm bashkësitë e energjisë. Nga ky këndvështrim, administrimi i të dhënave dhe aftësitë digjitale janë thelbësore për monitorimin e performancës së projekteve dhe për të kuptuar kërkesat lokale për energji. Autoritetet duhet të zhvillojnë partneritete me organizata ndërkombëtare, OJF, subjekte të sektorit privat dhe institucionet arsimore për shkëmbim njohurish, financim dhe mbështetje të projekteve.

Promovimi i energjisë nuk kërkon thjesht bashkëpunim mes aktorëve, por dhe ndërmjet sektorëve të ndryshëm, ku përfshihen banimi, transporti dhe mjedisi. Autoritetet duhet të jenë të afta që të formojnë grupe ndërdisiplinore ekspertësh nga sektorë të ndryshëm për të trajtuar sfidat që lidhen me ruajtjen e energjisë, lëvizshmërinë dhe infrastrukturën e rrjetit.

Të gjitha këto fusha paraqesin një sfidë për autoritetet publike, ndërsa subjektet private ndërkombëtare mund të luajnë një rol vendimtar në mbështetjen e autoriteteve publike për hartimin e kuadrit për komunitetet e energjisë dhe vetëprodhuesit. Mbështetja e tyre garanton që autoritetet publike të kenë njohuritë, mjetet dhe burimet e nevojshme për të rregulluar dhe nxitur në mënyrë të efektshme komunitetet e energjisë dhe vetëprodhimin. Ndiurma e tyre mund të përshtatet për të përmbushur objektivat dhe synimet e legjislacionit në sektorin e energjisë duke:

- organizuar trajnime për personelin e autoriteteve publike mbi praktikën më të mirë, teknologjitë e reja dhe kuadrot rregullatore inovative për komunitetet e energjisë dhe vetëprodhuesit.
- ofruar udhëzime për hartimin e politikave dhe rregulloreve që nxisin komunitetet e energjisë dhe vetëprodhimin.
- ndihmuar në hartimin ose rishikimin e ligjeve dhe rregulloreve për ti përshtatur me legjislacionin e BE-së në këtë fushë.

- kryer studime për integrimin në rrjet të komuniteteve të energjisë dhe vetëprodhuesve, etj.
- organizuar ngjarje për të mbledhur kontributet dhe për të trajtuar shqetësimet e grupeve të ndryshme të palëve të interesuara.

Me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, autoritetet mund tu ofrojnë bashkësive të energjisë ndihmesë teknike duke organizuar programe trajnimi ose punëtori mbi mënyrën e fillimit, menaxhimit dhe qëndrueshmërisë së një bashkësie energjetike. Duke ofruar këtë mbështetje, përfshirë trajnime mbi aspektet teknike, financiare dhe administrative, komuniteti mund të fuqizohet për të marrë përgjegjësi mbi projektet vendore të energjisë.

Në këtë këndvështrim, autoritetet mund të shkojnë dhe më tej për të lehtësuar zhvillimin e komuniteteve të energjisë duke ofruar shërbime këshillimi përmes krijimit të “one-stop shops” ose linjave telefonike ku anëtarët e komunitetit mund të marrin këshilla mbi çështjet rregullatore, teknike dhe financiare.

Autoritetet duhet të marrin parasysh dhe ndikimin social dhe drejtësinë në planifikimin e tyre, duke siguruar që bashkësitë e energjisë të ofrojnë akses të përbalueshëm dhe përfitime për familjet me të ardhura të ulëta dhe komunitetet e skajmuara. Investimi në këto kapacitete dhe aftësi do të mundësonte autoriteteve shqiptare që të japin mbështetje të gjithanshme për bashkësitë e energjisë, duke nxitur pavarësinë lokale energjetike, qëndrueshmërinë dhe reziliencën ekonomike.

6. MUNGESAT DHE PENGESAT

Në kuadër të këtij raporti, personave dhe bizneseve të ndryshme iu shpërnda një pyetësor që mbulonte aspekte që lidhen me kapacitetin e instaluar të familjeve dhe sipërmarrjeve, procedurat e instalimit, dokumentacionin zyrtar të nevojshëm, kostot financiare të përfshira, kohën dhe prirjen e instalimit të sistemit fotovoltaik (PV) në të ardhmen e afërt, si dhe disa rekomandime për vendimmarrësit.

Këto përgjigje tregojnë qëe një pjesë e konsiderueshme e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike për vetëkonsum vihen në punë kryesisht nga sipërmarrësit. Kapaciteti i instaluar në projektet e energjisë së rinovueshme nga njësi familjare përbën vetëm rreth 10–20% të kapacitetit mesatar të instaluar në projektet e sipërmarrjeve.

Sa u përket procedurave të aplikimit për instalimin e këtyre impianteve në sipërmarrje, shumica kanë raportuar se kanë punësuar specialistë brenda kompanisë. Përgjithësisht, subjektet e njohin ekzistencën e dokumenteve që duhen paraqitur, gjë që administrohet nga specialisti i kompanisë. Subjektet nuk kanë deklaruar një vlerë konkrete për koston e hartimit të dokumenteve, por theksojnë se procedurat zgjasin 2 muaj a më shumë (kryesisht për shkak të pretendimeve nga OShEE se sistemi nuk funksionon, problemeve me skanimin teknik, dokumenteve të pasakta, etj.)

Procedurat, në çdo rast, si për kapacitete instalimi të vogla, ashtu dhe për ato të mëdha, janë praktikisht të njëjta. Sa u përket prirjeve për instalime në vitet e ardhshme, nëse rritja do të vijojë apo do të stabilizohet, përgjigjet tregojnë që, deri tani, investitorët kryesorë kanë qenë bizneset. Megjithatë, në vitet në vijim pritet të ketë një rritje të instalimeve nga njësitë familjare.

Duke marrë parasysh pengesat e identifikuara nga palët e intervistuar, autorët e këtij raporti kanë vijuar të hetojnë më tej mbi pengesat që pengojnë vënien në jetë të fotovoltaikëve, siç paraqitet në tabelën vijuese:

FUSHA	FAKTORËT QË PENGJOJNË ENERGJINË DIELLORE FOTOVOLTAIKE(PV)
Kudri politik dhe ekonomik	• Ligji “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (2023) përcakton mekanizma të ndryshëm mbështetës, ku përfshihen marrëveshjet për blerjen e energjisë, kontratat me diferenca, me qëllim nxitjen e prodhimit të energjisë së rinovueshme. Megjithatë, aktet nënligjore specifike që përimitojnë procedurat dhe rregulloret ende nuk janë miratuar dhe, aktualisht, aktet nënligjore në zbatim të ligjit të mëparshëm nr.7/2017 mbeten në fuqi derisa të miratohen aktet e reja nënligjore. • Aktualisht, për projektet e energjive të rinovueshme mungon një politikë afatgjatë dhe koherente si dhe mbështetje ekonomike (p.sh. mungon një skemë kompensimi për vetëprodhuesit e energjisë së përtëritshme bazuar në metodologjinë e faturimit neto; gjithashtu e paqartë mbetet mënyra e përcaktimit të çmimit të energjisë elektrike nga ERE për energjinë e prodhuar nga vetëprodhuesit e rinovueshëm). • Nuk ka rregulla dhe rregullore që merren posaçërisht me gratë, pasi ndikimet gjinore të ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit energjetik nuk janë trajtuar në planet kombëtare të zbatimit.
Struktura e tregut	• Ndërsa sektori i energjive të rinovueshme është fitimprurës për kompanitë e mëdha, qytetarët aktualisht mbeten pas, nuk përfitojnë as mbështetje dhe as procedura të thjeshtuara • Sektori i energjive të rinovueshme shihet ekskluzivisht si mundësi për të nxjerrë fitim, ndërsa shoqëria më e gjerë, me qëllime të tjera si lufta kundër varfërisë energjetike apo ndryshimeve klimatike, nuk përfshihet. • Përfshirja e grupeve të cënueshme në projektet e energjive të rinovueshme nuk merret parasysh. Grupet e skajmuara nuk kanë mundësi të marrin kredi për të investuar në burime të përtëritshme, prandaj nuk kanë as interesin dhe as mundësinë për t’u përfshirë. • Modeli i Tregut të Energjisë në Shqipëri (2016) aktualisht nuk përfshin dispozita për komunitetet energjetike dhe vetëprodhuesit e energjisë.

Autorizime administrative	• I gjithë procesi administrativ për regjistrimin e projekteve të energjisë së rinovueshme është kompleks dhe i lodhshëm. • Një ndërtesë kolektive mund të përdorë energjinë elektrike të prodhuar vetëm për përdorim të përbashkët të ndërtesës (ndriçim shkallësh, ashensor dhe përdorime të ngjashme), por energjia nuk mund të ndahet mes banorëve që ndajnë ndërtesën, gjë që përbën pengesë për përhapjen më të gjerë të energjisë diellore në ndërtesat e banimit. Është e qartë që, ndonëse ligji ekziston, aktet nënligjore për zbatimin dhe vënien e tij në jetë mungojnë. • Mungesa e provave të pronësisë mbi tokën e ndërlikon procesin. Edhe pse certifikata e pronësisë së tokës është dokument ligjor, shumë pronarë tokash në Shqipëri ende nuk e kanë atë.
<i>Lidhja me rrjetin</i>	• Rregullimi dhe infrastruktura e papërshtatshme e rrjetit, ku përfshihet mungesa e fleksibilitetit dhe e kapaciteteve të magazinimit. • Mungesë investimesh në përmirësimin e rrjetit për të siguruar që rrjeti të mund të përballojë rritjen e pjesës së energjisë së rinovueshme (Agjencia Ndërkombëtare e Energjive të Rinovueshme, 2021, fq.24). • Plani 5-vjeçar i zhvillimit i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (DSO) duhet të trajtojë integrimin e energjive të rinovueshme, me vëmendje të posaçme te nevoja për fleksibilitet.

Tabela 3: Pengesa që pengojnë vënien në jetë të energjinë fotovoltaike
Burimi: Autorët

Sa u përket rekomandimeve për institucionet në nivel politik, por dhe për procedurën e lejeve për instalime, të intervistuarit kanë sugjeruar sa vijon:

- Aplikimi për impiante fotovoltaike deri në 10 kWp përbëhet vetëm nga një njoftim drejtuar në OShEE, në vend që të aplikohet fillimisht në bashki; më pas, i drejtohet OShEE-së me dokumente dhe kërkesa të ndryshme për tu plotësuar.
- Licensat e dhëna për sipërmarrjet kanë si kriter që kompania të ketë në staf tre inxhinierë (elektrik, hidro dhe era). Kjo strukturë duket jologjike për një kompani që fokusohet ekskluzivisht në fotovoltaike, pasi nuk duket të ketë asnjë arsye për prani të tre ekspertëve në fusha që nuk aplikohen.
- Në rastin e faturimit neto (net metering), ka një nevojë urgjente për akte nënligjore ose udhëzime zyrtare për t'u referuar. Zakonisht, aplikantët informohen përmes një postimi në Facebook që njofton për faturimin vjetor të energjisë elektrike.

7. PËRFUNDIME

Kuadri ligjor i Shqipërisë për energjinë e rinovueshme është përafruar me Direktivën e BE “Për energjinë e rinovueshme” (RED II). Ndërsa Shqipëria ka miratuar legjislacionin kryesor mbi energjinë e rinovueshme, aktet nënligjore për prodhues-përdoruesit dhe bashkësitë energjetike kanë mbetur në vend dhe nuk trajtojnë plotësisht nevojat praktike të këtyre grupeve. Disa pengesa strukturore pengojnë përafrimin e Shqipërisë me direktivat e BE-së, ku përfshihen integrimi i pamjaftueshëm në aktet nënligjore i qasjeve të energjisë komunitare dhe të drejtave të prodhues-përdoruesve, si dhe përfshirja e institucioneve të ndryshme që trajtojnë politikat e energjisë së rinovueshme. Gjithashtu, vetëprodhuesit përballen me sfida të shumta, ku përfshihen kosto të larta fillestare të investimeve dhe procedura të ndërlikuara aplikimi.

Procesi i aplikimit për lejimin e projekteve të energjisë së rinovueshme në Shqipëri perceptohet si jo i qartë dhe kohëzgjatës. Prodhues-përdoruesit dhe komunitetet e mundshme energjetike hasin kërkesa të paqarta dhe mbështetje të kufizuar nga autoritetet. Thjeshtimi i këtyre procedurave është vendimtar për të nxitur pjesëmarrjen.

Pavarësisht nevojës për rregulla të qarta, zhvillimi i komuniteteve energjetike në Shqipëri mund të shndërrojë peizazhin energjetik të vendit. Edhe pse procedurat dhe kërkesat duken të paqarta, qeveria shqiptare shpreh qartë në Strategjinë Kombëtare të Energjisë objektivat për arritjen e sigurisë energjetike, tranzicionin drejt energjisë së rinovueshme, përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe përafrimin me standardet e tregut të energjisë të Bashkimit Europian. Gjithashtu, ligji “Për burimet e rinovueshme të energjisë” (2023) vendos objektiva të qarta për rritjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, garantimin e përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare si Traktati i Komunitetit të Energjisë, dhe për të nxitur integrimin rajonal, ndërkohë që përkrah rritjen ekonomike në zonat rurale dhe të izoluara.

Për të trajtuar cënueshmëritë, vëmendja e qeverisë është te shtimi i energjisë diellore, eolike dhe burimeve të tjera të rinovueshme për të ulur varësinë nga hidrocentralet dhe rreziqet klimatike. Ky ndryshim përmirëson sigurinë energjetike, ul lëshimin e gazrave serrë dhe mbështet objektivat globale të klimës. Projektet e vogla të energjisë së rinovueshme dhe vetëprodhuesit luajnë një rol kyç duke decentralizuar prodhimin e energjisë dhe duke përfshirë bashkësitë vendore.

Ligji “Për energjinë e rinovueshme” i vitit 2017 vendosi bazat për projektet e vogla diellore, ndërsa ligji “Për energjinë e rinovueshme” i vitit 2023 paraqiti një kuadër më të gjerë për vetëprodhuesit e energjisë dhe komunitetet energjetike. Ky legjislacion synon të lehtësojë integrimin e burimeve të shpërndara të energjisë së rinovueshme përmes masave si tarifat feed-in, faturimi neto dhe procedurat e thjeshtuara të lejeve. Gjithsesi, mbeten disa hendeqe.

Metodologjia për kompensimin e vetëprodhuesve të energjisë së rinovueshme ende nuk është miratuar, çka krijon pasiguri për investitorët dhe pjesëmarrësit e mundshëm. Për më tepër, ERE nuk ka vendosur tarifa kompensimi për energjinë e tepërt që futet në rrjet. Ndërkaq, energjia e tepërt transferohet te Furnizuesi i Shërbimit Universal pa kompensim, një praktikë që minon qëndrueshmërinë financiare të projekteve të vetëprodhimit dhe pengon pjesëmarrjen më të gjerë. Për shkak të disa pengesave, nismat gjithëpërfshirëse që udhëhiqen nga komunitetet mbeten të rralla.

Proceset e gjata dhe komplekse të licensimit, vështirësitë në sigurimin e lidhjeve me rrjetin dhe mekanizmat e paqarta të përcaktimit të çmimit për energjinë e rinovueshme kontribuojnë në zhvillimin e ngadaltë të komuniteteve energjetike. Interesi në rritje për larmi në burimet e përtëritshme të energjisë, ku përfshihen ato diellore dhe eolike, ka krijuar nevojë urgjente për një rrjet më të qëndrueshëm dhe adaptues. Modernizimi i rrjetit për të përballuar këto burime është i domosdoshëm për sigurimin e integritetit të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë së prodhuar nga komunitetet. Infrastruktura aktuale e rrjetit në Shqipëri nuk është projektuar për të përballuar kapacitetin shtesë nga instalime të decentralizuara të energjisë së rinovueshme, veçanërisht nga fermat diellore dhe eolike (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme, 2021, fq.24).

Instalimet e energjisë së rinovueshme dhe investimet në Teknologjitë e Rrjetit të Zgjuar (Smart Grid), shfrytëzojnë teknologji të përparuara si matësit e zgjuar, sistemet e monitorimit në kohë reale dhe kontrollin automatik, me qëllim që të përmirësojnë efikasitetin dhe besueshmërinë e rrjetit.

Siç u përmend, politikat dhe rregulloret aktuale në Shqipëri nuk trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme nevojat e prodhues-përdoruesve dhe të bashkësive energjetike, duke i lënë ata me mbështetje dhe mbrojtje të kufizuar.

Si kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian, Shqipëria ka qasje në një sërë mundësish financimi nga programet e BE-së dhe organizatat ndërkombëtare. Këto fonde mund të mbështesin zhvillimin dhe zgjerimin e bashkësive energjetike përmes financimit të studimeve paraprake, ofrimit të asistencës teknike dhe subvencionimit të instalimeve të sistemeve të energjisë së rinovueshme. Nismat për ndërtimin e kapaciteteve dhe fushata ndërgjegjësimi publik janë po aq të qenësishme për edukimin e aktorëve mbi përfitimet nga energjia e rinovueshme dhe për të nxitur pjesëmarrjen në projektet e bashkësive energjetike. Bashkitë kanë një rol kyç në këtë proces. Duke ofruar tokë për instalimet e energjisë së rinovueshme, duke thjeshtuar procedurat lokale të lejeve dhe duke angazhuar qytetarët në planifikimin dhe zbatimin e projekteve, bashkitë mund të krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin e komuniteteve energjetike. Partneritetet midis bashkive, kompanive private dhe anëtarëve të komunitetit mund të përmirësojnë më tej suksesin e këtyre projekteve duke gërrshetur burime financiare, ekspertizë teknike dhe mbështetje operative.

Në përfundim, bashkësitë energjetike përfaqësojnë një mundësi shndërrimi për Shqipërinë në arritjen e objektivave të saj të tranzicionit energjetik. Politikat dhe rregulloret aktuale në Shqipëri nuk trajtojnë si duhet nevojat e prodhues-përdoruesve dhe bashkësive energjetike, duke i lënë ata me mbështetje dhe mbrojtje të kufizuar. Duke nxitur bashkëpunimin midis qytetarëve, sipërmarrjeve dhe autoriteteve vendore, këto nisma mund të përshpejtojnë kalimin drejt një sistemi energjetik më të qëndrueshëm, rezistent dhe gjithëpërfshirës. Kapitulli i ardhshëm paraqet rekomandime se si Shqipëria mund të çlirojë potencialin e plotë të bashkësive energjetike, duke siguruar një të ardhme energjetike më të pastër, më të sigurt dhe ekonomikisht më të gjallë.

Në ligje dhe akte nënligjore njihet se nxitja e prodhues-përdoruesve të energjisë - konsumatorë që gjithashtu prodhojnë energji, zakonisht përmes burimeve të rinovueshme si diellore ose eolike -mund të ndihmojë ndjeshëm Shqipërinë në afrimin drejt objektivave të saj për energjinë e rinovueshme, uljen e varësisë nga importet dhe përmirësimin e sigurisë energjetike. Për të vlerësuar se si duhet nxitur veprimtaria e prodhues-përdoruesve, duhet parë se çfarë mungon në legjislacionin aktual dhe çfarë pengesash perceptojnë konsumatorët.

Prodhues-përdoruesit dhe Komunitetet e Energjisë

Pa një kuadër rregullator të qartë (akte nënligjore) të hartuar posaçërisht për vetëprodhuesit dhe komunitetet energjetike, ka ende pengesa në investimin në projekte të energjisë së përtëritshme, siç janë forma ligjore e bashkësive energjetike, sikurse u lartpërmend lidhur me qasjen në rrjet dhe përcaktimin e çmimit të energjisë. Kjo mungesë qartësie mund të çmotivojë komunitetet nga ndjekja e projekteve të tilla.

Është thelbësore që në Shqipëri të miratohet një rregullore për matjen me neto-faturim (net billing) dhe rregulla të tjera përkatëse sipas nenit 20 (2023), që mbulojnë procedurat e aplikimit, kërkesat teknike, rregullat për shitjen e energjisë së vetëprodhuar dhe matjen vjetore të saj.

Një çështje tjetër për tu marrë parasysh është se subvencionet dhe grantet për panelet diellore, përmes granteve direkte ose kredive me interesa të ulëta, janë të domosdoshme për të mbuluar kostot e instalimit për sistemet diellore në familje dhe sipërmarrjet e vogla. Kjo do të ndihmonte në lehtësimin e kostove të larta fillestare, të cilat shpesh përbëjnë një barrierë për hyrjen në treg.

Shumica e konsumatorëve e çmojnë procesin e lidhjes së individëve dhe bizneseve me rrjetin si të paqartë. Thjeshtimi i procedurave të lejeve, lidhjes dhe kërkesave për raportim mund të nxisë më shumë njerëz që të marrin pjesë. Investimi për t'u bërë prodhues-përdorues apo për të qenë pjesë e një bashkësie energjetike nuk është vetëm çështje financiare; ai kërkon një sërë hapash burokratike që konsumatorët duhet t'i ndjekin për tu lidhur me rrjetin.

Autoritetet dhe OJF-të duhet të nxisin fushata ndërgjegjësimi mbi përfitimet ekonomike dhe mjedisore nga të qenit prodhues-përdorues. Kjo mund të përfshijë punëtori', seminare dhe partneritete me shkollat për të rritur ndërgjegjësimin mbi energjinë e rinovueshme dhe mundësitë nga të qenit prodhues-përdorues.

Me futjen në ligj të konceptit të komuniteteve të energjisë së rinovueshme, rëndësi merr mbështetja e bashkësive energjetike dhe prodhues-përdoruesve në Shqipëri, veçanërisht konsumatorët e cënueshëm. Disa masa mbështetjeje mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

1. Mbështetje Politike: Hartimi i akteve nënligjore sipas kërkesave të ligjit, duke u fokusuar në pakësimin e pengesave administrative dhe ofrimin e subvencioneve për familjet me të ardhura të ulëta.
2. Ndihmë Financiare: Krijimi i fondeve të dedikuara, ofrimi i kredive me interes të ulët dhe nxitja e partneriteteve publik–privat për projektet e energjisë së rinovueshme.
3. Përmirësime të Rrjetit: Modernizimi i infrastrukturës së rrjetit për energjinë e prodhues-përdoruesve dhe zbatimi i tarifave të posaçme për konsumatorët e cënueshëm.
4. Ngritje Kapacitetesh: Ofrim trajnimesh, rritje ndërgjegjësimi dhe mbështetjeje për bashkëpunimet lokale për ngritjen e bashkësive energjetike.
5. Monitorim: Caktim i objektivave të matshme, ndjekja e ecurisë dhe përshtatja e politikave bazuar në feedback-un e komunitetit.
6. Projekte pilot: këto janë një hap thelbësor për të treguar qëndrueshmërinë e komuniteteve energjetike në Shqipëri. Shembuj të suksesshëm mund të tregojnë përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore nga nismat për energji të përtëritshme të udhëhequra nga komuniteti, duke rritur besimin e publikut dhe duke nxitur pjesëmarrjen më të gjerë.
7. Bashkëpunim me organizata europiane: Këmbimi i përvojave me organizata ombrellë europiane si Rescoop.eu, BBEn (Gjermani), EnergieSamen (Holandë) dhe planet për krijimin e një organizate mbështetëse për të nxitur zhvillimin e komuniteteve energjetike.

Duke mbështetur prodhimin dhe konsumin lokal të energjisë, prodhues-përdoruesit dhe bashkësitë energjetike mund të ulin varësinë nga energjia e importuar, të ulin kostot e energjisë elektrike dhe të gjenerojnë përfitime ekonomike si krijimi i vendeve të punës dhe rritja e të ardhurave lokale. Përpos këtyre, ato mund të nxisin autonominë energjetike, duke fuqizuar komunitetet që të marrin kontrollin mbi nevojat e tyre energjetike dhe të kontribuojnë në tranzicionin energjetik kombëtar.

Lidhja me Rrjetin dhe Infrastruktura

Një nga problemet kryesore që shoqëron projektet e energjisë së rinovueshme është integrimi i prodhimit të decentralizuar të energjisë elektrike në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit. Ka një nevojë urgjente për përmirësime në infrastrukturën e rrjetit për të mbështetur një bazë në rritje të prodhues-përdoruesve dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit. Rrjeti elektrik i Shqipërisë mund të mos jetë plotësisht i përgatitur për të integruar burime të energjisë së rinovueshme në shkallë të madhe, si era ose dielli. Duket e rëndësishme që, përveç legjisllacionit të duhur dhe aspekteve teknike dhe financiare, të merren parasysh dhe pengesat administrative për zbatimin me sukses të projekteve të energjisë së rinovueshme.

Thjeshtimi i procesit të lidhjes me rrjetin dhe garancia në respektimin e afateve janë thelbësore. Enti Rregullator i Energjisë duhet të mbikëqyrë si duhet afatet për çdo

fazë të procesit të lidhjes me rrjetin, duke përfshirë dorëzimin e aplikimeve, rishikimin, vlerësimet teknike, miratimin përfundimtar, si dhe të marrë parasysh rishikimin e rregullave ekzistuese të lidhjes. Gjithashtu, ka rendësi krijimi i një pike të centralizuar ku aplikantët të mund të marrin udhëzime, të dorëzojnë aplikimet dhe të bashkërendohen me autoritetet dhe operatorët përkatës. Kjo qasje ul nevojën që aplikantët të enden në institucioneve të shumta dhe përshpejton procesin në tërësi.

Gjithashtu, investimi në teknologjitë e rrjetit të zgjuar është i domosdoshëm për modernizimin e infrastrukturës elektrike të Shqipërisë dhe për ofrimin në kohë reale të të dhënave mbi prodhimin dhe konsumimin e energjisë, duke mundësuar parashikim më të saktë të kërkesës dhe alokimit më efikas të burimeve.

Legjislacioni dhe zbatimi i ligjeve

Bashkë me nevojën për miratimin e ligjit dhe të akteve nënligjore, për zbatimin dhe zhvillimin e duhur të projekteve të energjisë së rinovueshme është thelbësore garancia që legjislacioni mbi sektorin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri të jetë i qartë dhe çdo ndryshim të jetë i lehtë për tu aksesuar nga investitorët potencialë dhe prodhues-përdoruesit qytetarë. Arritja e këtij qëllimi do të përfshinte:

1. Platformë Online e Dedikuar – Krijimi nga qeveria i një portali online kushtuar legjislacionit për energjinë e rinovueshme, ku publikohen ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe ndryshimet, dhe ku përdoruesit mund të gjejnë lehtësisht legjislacionin specifik.
2. Përshkrim i Përdorshëm i Legjislacionit – përshkrim i legjislacionit i kuptueshëm lehtësisht edhe nga joekspertët. Shpërndahen udhëzime të qarta dhe paketa me mjete (toolkits) mbi mënyrat se si qytetarët mund të bëhen prodhues-përdorues, duke përfshirë hapat për marrjen e lejeve, lidhjen me rrjetin dhe përfitimet e mundshme.
3. Angazhimi i Palëve të Interesuara – Organizim i rregullt i punëtorive me palët e interesuara, ku përfshihen investitorët, qytetarë prodhues-përdorues, OJF dhe autoritetet vendore, për të shpjeguar ndryshimet legjislative dhe për të mbledhur reagime për përmirësime në kuadrin ligjor.
4. Trajnimi i Autoriteteve Lokale – Trajnimi i zyrtarëve të qeverisjes lokale dhe ekspertëve të Autoritetit Rregullator të Energjisë për të kuptuar dhe komunikuar efektshëm legjislacionin për energjinë e rinovueshme, si dhe për të thjeshtuar dhe standardizuar proceset e aplikimit për lejet e instalimeve të vogla të energjisë së rinovueshme.
5. Mbikëqyrja dhe Rishikimi – Organet publike monitorojnë rregullisht legjislacionin mbi projektet për energjinë e rinovueshme për të rishikuar dhe vlerësuar zbatimin e ligjeve për energjinë e rinovueshme, për të diktuar nevoja për ndryshime në ligje dhe akte nënligjore, që legjislacioni për energjinë e rinovueshme të përafrohet me direktivat e BE-së për energjinë dhe mjedisin.

Kohezioni politik

Për të përmirësuar kohezionin politik në Shqipëri midis energjisë së rinovueshme dhe fushave që lidhen me të, kërkohet një rishikim i rregullt për të përafruar projektet e energjisë së rinovueshme me nevojat lokale social-ekonomike dhe mjedisore, duke marrë parasysh përdorimin e tokës dhe ndikimin ekologjik. Kërkohen korniza politike të integruara për të miratuar strategji ndërsektorale që integrojnë qartësisht objektivat për energji të përtëritshme me ndryshimet klimatike, ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e tokës, bujqësinë dhe politikat sociale. Për një bashkërendim të duhur të organeve të ndryshme publike, sugjerohet krijimi i një task-force ose agjencie ndërministrare, jo vetëm për të koordinuar organet publike, por dhe për të garantuar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të bashkësive vendore, OJF-ve, aktorëve të sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë në hartimin e politikave, për të pasur këndvështrime të ndryshme dhe për të harmonizuar zhvillimin e energjisë së rinovueshme me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetin dhe përdorimin e tokës, duke përfshirë dhe vlerësimin e ndikimit të projekteve të energjisë së rinovueshme mbi klimën, biodiversitetin dhe faktorët socialë.

9. BIBLIOGRAFIA

Albania, R. o. (2019). Guidance on self-producer connection to the grid. Retrieved from <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/Udhzim-Nr.-3-dat-20.6.2019.pdf>

European Union. (2006). The Energy Community Treaty. Retrieved from [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22006A0720\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22006A0720(01))

European Union. (2018). Renewable Energy Directive EU/2018/2001. Retrieved from <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2018/2001/oj/eng>.

European Union. (2019). Electricity Market Directive, 2019/944/EU.

European Union. (2022). REPowerEU. Affordable, secure and sustainable energy for Europe. Retrieved from https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/repowereu-affordable-secure-and-sustainable-energy-europe_en.

European Union. (2023). Albania 2023 Report. Retrieved from https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en.

European Union. (2023). Renewable Energy Directive EU/2023/2413. Retrieved from <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32023L2413&qid=1699364355105>.

Eurostat. (2023). <https://ec.europa.eu/eurostat/en/web/products-eurostat-news/w/ddn-20231222-2>.

Federal Republic of Germany. (2023). Gesetz für den Ausbau erneuerbarer Energien (Erneuerbare-Energien-Gesetz - EEG 2023).

GIZ. (2022). Open Regional Fund for South East Europe: Energy, Transport and Climate Protection. Retrieved from <https://www.giz.de/en/downloads/giz2022-en-ORF-ETC.pdf>

Green Economy Financing Facility. (2024). GEFF - Where finance and green technologies meet. Retrieved from <https://ebrdgeff.com/>

Hørman, M., Georgiev, I., & Jespersen, M. (2022). EU's global leadership in renewables – Final synthesis report 2021. European Commission: Directorate-General for Energy. International Renewable Energy Agency. (2021).

Renewables Readiness Assessment: Albania,. Retrieved from https://www.irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2021/March/IRENA_RRA_Albania_2021.pdf

Interreg. (2021). The Interreg “Greece – Albania” programme. Retrieved from <https://greece-albania.eu/>

OSHEE. (2025). Veteprodhuesit. Retrieved from <https://oshee.al/veteprodhuesit-2/>

Republic of Albania. (2018a). National Action Plan on Renewable Energy Sources 2018-2020. Retrieved from <https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC181524/>

Republic of Albania. (2015). Law 43/2015. On Power Sector. Retrieved from https://www.ere.gov.al/doc/Law_on_energy_sector_approved_on_43.2015.pdf.

Republic of Albania. (2016). On approval of the electric power market model. Retrieved from http://www.ere.gov.al/doc/Decision_No-519-dt-13-July-16_Market_Model.pdf

Republic of Albania. (2017). Law 7/2017. Retrieved from On Promoting Energy Use from Renewable Energy Sources: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/ALB181604.pdf>

Republic of Albania. (2018). National Energy Strategy 2018-2030. Retrieved from https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/Vendim-i-KM_480_31.07.2018.pdf

Republic of Albania. (2023). Law 24/2023. The Promotion of the Use of Energy from E Sources. Retrieved from https://ere.gov.al/media/files/2024/01/31/Law_no._24_2023_On_the_promotion_of_the_use_of_energy_from_renewable_sources.pdf.

Republic of Albania. (2024). National Energy and Climate Plan of the Republic of Albania. Retrieved from <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/The-National-Energy-and-Climate-Plan-NECP.pdf.pdf>.

Swiss State Secretariat for Economic Affairs. (2022). Smart Energy Municipalities Project (SEMP). Retrieved from <https://www.eda.admin.ch/countries/albania/de/home/aktuell/news.html/content/countries/albania/en/meta/news/embassy/2022/smart-energy-project>

United States Congress. (2022). Inflation Reduction Act. Retrieved from https://www.democrats.senate.gov/imo/media/doc/inflation_reduction_act_of_2022.pdf

RRETH PROJEKTIT

Shqipëria është pothuajse tërësisht e varur nga hidrocentralet për rreth 90% të prodhimit të saj të energjisë elektrike dhe po përballet gjithnjë e më shumë me situata të parashikuara hidrologjike ekstreme në të ardhmen, çka sjell rreziqe për sigurinë e furnizimit me energji. Megjithatë, si anëtare e Komunitetit të Energjisë dhe vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria është angazhuar të dekarbonizojë ekonominë e saj, të rrisë eficiencën e energjisë, të shfrytëzojë potencialin e energjive të rinovueshme dhe të diversifikojë prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrale drejt burimeve të tjera të rinovueshme. E shtyrë nga motivimi për të rritur sigurinë e saj energjetike, për t'u mbrojtur nga rritja e çmimeve të energjisë dhe për të marrë një rol aktiv në luftën kundër ndryshimeve klimatike, qytetarët dhe bizneset në rajon po i drejtohen gjithnjë e më shumë energjisë së rinovueshme, pavarësisht sfidave të shumta.

Projekti synon të promovojë energjitë e rinovueshme në Shqipëri, të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve në tranzicionin energjetik dhe njëkohësisht të forcojë barazinë gjinore. Konkretisht, sipërmarrëset shqiptare në zonat rurale, familjet me të ardhura të ulëta dhe të rinjtë do të aftësohen të njohin dhe të kuptojnë potencialin e energjisë komunitare, si edhe vetë-konsumit dhe vetë-prodhimit të energjisë së rinovueshme për veprim individual. Këto grupe të synuara duhet të motivohen dhe fuqizohen që të angazhohen vetë në këtë drejtim.

Vetë-konsumi i energjisë së rinovueshme mund të ndihmojë Shqipërinë të shfrytëzojë potencialin e saj të madh të energjive të rinovueshme dhe të ndërtojë sisteme energjetike të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, duke ulur varësinë nga importi dhe lëndët djegëse fosile.

Kontaktet:

WECF e.V.
annemarie.mohr@wecf.org
www.wecf.org

Milieukontakt Shqipëri
valbona.mazreku@milieukontakt.org
www.milieukontakt.org

Botuesi:
Milieukontakt Shqipëri
Sheshi Avni Rustemi, P. Teuta Konstruktion
Tiranë, Shqipëri
www.milieukontakt.org

Në bashkëpunim me:
WECF e.V. – Women Engage for a Common Future
St.-Jakobs-Platz 10
80331 Mynih, Gjermani
www.wecf.org

Autorët:
Ersida Teliti, Eksperte Ligjore
Valbona Mazreku & Arion Sauku (Milieukontakt Shqipëri)
Katharina Habersbrunner & Johannes Baumann (WECF e.V.)

Mbështetur financiarisht nga:
German Federal Environmental Foundation (DBU)
WECF International
EWS Elektrizitätswerke Schönau

Opinionet e shprehura në këtë raport janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e German Federal Environmental Foundation (DBU), WECF International ose EWS.